

VENDIM
Nr.89, datë 21.3.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.19, DATË
1.2.1990 “PËR DISA MASA PËR PLOTËSIMIN MË MIRË TË NEVOJAVE PËR BANIM”**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe të Ministrisë së Ekonomisë Komunale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.19, datë 1.2.1990, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Në qytete, ndërtimi i banesave vetjake të bëhet nga shtetasit, nga ndërmarrjet e sistemit të ndërtimit ose edhe nga ndërmarrje të tjera që kanë veprimtari ndërtimi. Vlerësimi i punimeve për ndërtimin e apartamenteve vetjake të grupuara të bëhet me çmimet e manualit të Ministrisë së Ndërtimit, kurse për ndërtimin e banesave vetjake të veçuara të bëhet me çmimet e manualeve të Ministrisë së Ekonomisë Komunale. Këto kritere zbatohen edhe për shitjen e apartamenteve të grupuara dhe të banesave të veçuara.

Për ndërtimin e banesave vetjake ndërmarrjet lidhin kontratë me shtetasit, ku përcaktohen detyrimet e ndërsjella”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI